

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: SHËRBIME MIRËMBAJTJE TË ZAKONSHME TË
PEMËVE, ULLISHTAVE, VRESHTAVE, AGRUMEVE DHE SHËRBIME NË SERRË**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 77100000-1;
77211500-7 ; 77120000-7;**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4,774,586 (Katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë
e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Lekë, pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, Ligjin nr.17/2020 “Për produktet plehëruese”, Ligjin nr.10416, datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor; i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operoret ekonomike pjesëmarrës, duhet të jene te licencuar dhe te paraqesin Licence për kategorinë II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne zbatim te ligjit nr.10 081, date 23.02.2009, si dhe në zbatim të vendimit nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Kërkesa për këtë licencë lidhet drejtëpërdrejtë me natyrën e shërbimeve objekt prokurimi, pasi Specifikimet teknike parashikojnë kryerjen e trajtimeve me produkte fitosanitare dhe biocide, përfshirë spërkatje me preparate me bazë bakri, përdorim insekticidesh, si dhe ndërhyrje kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Këto veprimtari përbëjnë ndërhyrje higjieno sanitare me përdorim të substancave kimike/biocide, veprimtari të cilat duhet të realizohen nga ofertues të cilët kanë njohuritë, aftësitë, përvojën, besueshmërinë profesionale për kryerjen e tyre.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a. 1 (një) Agronom
- b. 5 (pesë) punonjës/punëtorë

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës

Për punonjës në pikën b duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

Punonjësit e kërkuar në mënyrë të kombinuar mund të përmbushin një apo disa profile.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe specifikimeve teknike, termat e referencës, hartuar nga AK.

Për shkak të natyrës teknike të objektit të prokurimit, ku përfshihet mirëmbajtja e pemëve frutore, vreshatave, ullishtave dhe agrumeve, si dhe kryerja e trajtimeve fitosanitare, krasitje, plehërim, menaxhim ujitje dhe monitorim të sëmundjeve dhe dëmtuesve. Këto shërbime kërkojnë njohuri profesionale mbi fiziologjinë dhe ciklin biologjik të kulturave bujqësore, përcaktimin e saktë të dozës së aplikimit të produkteve fitosanitare, identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, zbatimin e teknikave të duhura të krasitjes dhe menaxhimit të kurorës. Këto njohuri janë pjesë e formimit profesional të agronomit, i cili është profili I cili garanton zbatimin teknik korrekt të shërbimeve të përcaktuara.

Prania e minimalisht e 5 (pesë) punonjësve garanton kapacitetin real të operatorit ekonomik për realizimin e punimeve me krahë, në kohë dhe sipas volumit të kërkuar. Kërkimi i kontratave të punës vërteton angazhimin real dhe përgjegjësinë e operatorit ekonomik në zbatimin e kontratës.

AK ka përcaktuar që ofertuesi të disponojë stafin Teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, nga punonjës të pajisur me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, ku përfshihet kryerja e trajtimeve fitosanitare me produkte kimike/biocide, punime me krah me mjete mekanike, veprimtari të cilat paraqesin rrezik potencial për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve nëse nuk zbatohen masa përkatëse.

Sa më sipër, kjo kërkesë është proporcionale me natyrën e shërbimeve dhe synon garantimin e zbatimit të kontratës në kushte sigurie dhe në përputhje me standartet ligjore.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimalisht pajisjet dhe mjetet e nevojshme mekanike (mjete për punime, shpërdarje plehu), dhe mjetet e punës si vegla pune, vegla krasitëse, pompa spërkatëse dhe pompë për spërkatje me herbicid.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumentacion për pajisjet dhe mjetet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe mjete i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me të gjitha proceset që duhet të kryejë ofertuesi për realizimin e shërbimit, objekt prokurimi, siç është: plugimi, shpërndarja e plehut, spërkatje, krasitje, spërkatje me herbicide, punime me bel, prashitje, ujitje, etj.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuara nga titullari i autoritetit kontraktor **“Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë”**, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 *“Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”*, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës /përlllogaritja e fondit limit janë hartuara nga AK për llogari të së cilit po zhvillohet procedura e prokurimit, duke mbajtur në konsideratë si vijon:

Baza Eksperimentale e QTTB Vlorë në Shamogjin ka një sipërfaqe prej 57 ha. Në këtë sipërfaqe janë vendosur koleksione dhe parcelat mëmë të pemëve frutore ullirit. agrumeve, hardhisë autoktone dhe të huaj të cilat zënë një sipërfaqe prej rreth 32 ha.

Këto koleksione janë bazë e rëndësishme e resurseve gjenetike të pemëve frutore, ullitit, hardhisë dhe agrume. Duke filluar me koleksionin e parë të ullirit të ngritur në vitin 1974, kur territori i Bazës Eksperimentale të sotme filloi nga puna si stacion eksperimental, e duke u shtuar e pasuruar në etapa të ndryshme kohore me kulturat drufrutore bërthamore, me hardhinë, agrumet dhe gjithë drufrutorët e tjerë të racave autoktone, së pari shërbejnë për ti ruajtur nga erozioni gjeneti(humbja). Është fenomen që po ndodh nga braktisja e pemëtoreve të vjetra, nga zëvendësimi i pemëve ekzistuese me varietete të huaja, ndonjëherë edhe të pa testuara, nga dëmtimi nga sëmundjet, dëmtuesit, zjarret e fenomene natyrore.

Së dyti ato janë bazë e rëndësishme për marjen e materialit për shtim të këtyre kultivarëve nga ana e fidanërritësve dhe fermerëve për mbjelljet e reja.

Së treti duke u mbjellë në koleksion në të njëjtin mjedis dhe përkujdesje, kultivarët e grumbulluar nga kushte e mjedise të ndryshme, krahasohen më mirë për potencialin e tyre biologjik e agronomik.

Veç të tjerave, këto koleksione shërbejnë për testim të praktikave inovative në funksion të përmirësimit të teknologjisë, për testim inputesh të reja, për kryerjen e shumë demostrimeve dhe trajnimeve me fermerët e specialistët , praktika me studentët etj.

Për t'i mbajtur këto parcela në gjendje të mirë, kanë nevojë për shërbime agroteknike gjatë gjithë vitit. Shërbimet e mirëmbajtjes konsistojnë në menaxhimin e tokës, plehrimin, ujitjen, kullimin menaxhimin e kurorës dhe vegjetacionit, mbrojtjen fitosanitare dhe shërbime të tjera në funksion të përmirësimit të prodhimtarisë dhe cilësisë së tij.

Duke u bazuar në teknologjinë tip që do të zbatohet për secilën kulturë, nga specialistët e Departamentit të Pemëtarisë janë hartuar kontot për vitin 2026. Sasitë dhe volumet e punimeve reflektojnë sipërfaqet e koleksioneve dhe numrin e bimëve për çdo parcelë.

NJËSIA E PROKURIMIT